



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:259830
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06030107

Kom.Dh.Shk.II.nr.1157/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Mani Group Sh.P.K., me seli në Malishevë, rr. “Imer Krasniqi”, e përfaqëson sipas autorizimit Shqiponjë Beqiraj, avokate nga Peja, kundër debitorit Shkëmbi-Gllarevë Sh.P.K., me seli në Klinë, e përfaqëson me autorizimi Jeton Osmani, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1998/23, të datës 27.12.2023, me datë 07.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Shkëmbi - Gllarevë Sh.P.K., me seli në Klinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1998/23, të datës 27.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1998/23, të datës 27.12.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Shkëmbim-Gllarevë Sh.P.K., me seli në Klinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj P.nr.163/2023 të dt. 22.06.2023, në pikën II të dispozitivit ka mbetur në fuqi urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Shpend Ahmetaj P.nr.163/2023 të dt. 22.06.2023 dhe në pikën III të dispozitivit detyrohet debitori që në emër të shpenzimeve të përpilimit të përgjigjes në prapësim të paguaj shumën prej 104.00 euro në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e

shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, dhe kjo çështje ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala kreditori, duke kundërshtuar pretendimet e debitori në ankes dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitori si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

- *Ankesa e debitorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 21-SHP01-001-337 të datës 24.09.2021, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 4,400.57 euro, me kamatë ligjore prej 8% si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore sipas tarifës së OAK-së.

Përmbartuesi privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.163/2023 të dt. 22.06.2023, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se ky urdhëri është i parakohshëm, pasi që nuk është arritur kushti ose afati për përmbartim e obligimit sipas faturës së lartë cekur, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi dhe të obligohet kreditorit të paguaj shpenzimeve për përpilimin e prapësimi në shumë prej 104.00 euro .

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, duke propozuar që të refuzohet prapësimi si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhërin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1998/23, të datës 27.12.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Shkëmbim-Gllarevë Sh.P.K., me seli në Klinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj P.nr.163/2023 të dt. 22.06.2023, në pikën II të dispozitivit ka mbetur në fuqi urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat Shpend Ahmetaj P.nr.163/2023 të dt. 22.06.2023 dhe në pikën III të dispozitivit detyrohet debitori që në emër të shpenzimeve të përpilimit të përgjigjes në prapësim të paguaj shumën prej 104.00 euro në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës, deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim të dokumentit të besueshëm - Fatura e lartë cekura, në emër borxhit për shumën e mjeteve, në lartësi prej 4,400.57 euro, mbi bazë të së cilës përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin, por ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par 1, 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e

ka cilësinë e dokumentit përmbartimor, e po ashtu nga shiqimin në këtë dokument rezulton se përmban të gjitha elementet e kërkuar nga këto nene, të cilat janë përshkruar shërbimet, shumën e detyrimi dhe kohen e përmbushjes dhe fatura është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka mbet në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dyte, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, që është në përputhje me dispozitën nga neni 37 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku Përcakton se, Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në origjinal. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm- Faturës Nr. 21-SHP01-001-337 të datës 24.09.2021, ku me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se, Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- fatura e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është treguar debitori, përkatësisht i njëjti përmban të gjitha elementet të mjaftueshëm në kuptim të plotësisimit sipas neneve të lartcekura nga LPP-ja. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dyte, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbartimor në origjinal dhe është pranuar nga ana e debitorit në mënyrë të rregullt duke e nënshkruar si institucion. Sa i përket shpenzimeve, me të drejtë është vendosur bazuar në nenin 463 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke njohur shpenzimet e kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për të provuar pretendimet e tyre rreth mos paraqitja e faturave në origjinal sipas nenit 40 të LPP-së, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të përshtatshme për përmbartim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Numri i lëndës: 2023:259830
Datë: 08.08.2024
Numri i dokumentit: 06030107

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1157/2024, me datë 07.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v